

VENDIM
Nr. 742, datë 5.9.2013

**PËR LEJIMIN E MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SHKENCËS PËR KRYERJEN E
PROCEDURËS SË PROKURIMIT PËR SHËRBIMIN E INTERNETIT NË SHKOLLAT DHE
INSTITUCIONET E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DHE BOTIMIT TË ÇDO LLOJ
NJOFTIMI PROKURIMI PËR KËTË SHËRBIM**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, dhe të vendimit nr. 591, datë 10.7.2013 të Këshillit të Ministrave “Për disiplinimin e përdorimit të shpenzimeve buxhetore, për vitin 2013”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës për kryerjen e procedurës së prokurimit për shërbimin e internetit në shkollat dhe institucionet e arsimit parauniversitar dhe botimit të çdo lloj njoftimi prokurimi për këtë shërbim me fondet e parashikuara në Buxhetin e Shtetit, për vitin 2013, brenda datës 31 dhjetor 2013. Brenda këtij afati përfshihen lidhja e kontratës përkatëse dhe publikimi i njoftimit të kontratës së nënshkruar në Buletinin e Njoftimeve Publike.

2. Ngarkohen Ministra e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Financave dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha